(b)cmimet aktuale te pasurive të patundshme të ngjashme në tregje më pak aktive, të korrektuara në mënyrë që të reflejktojnë ndryshimet e kushteve ekonomike të ndodhura që nga koha e vendosjes së cmimeve; dhe

(c) skontimi i projeksioneve të flukseve të parase bazuar në vleresime të besueshme, të mbështetura në kushtet e qerave ekzistuese dhe kontratave të tjera (kur është e mundur) me evidencë të pavarur për tregun e qerave për pasuri të ngjashme në lokalitete dhe kushte të ngjashme,dhe duke përdorur norma skontimi që reflektojnë vleresimet aktuale per paqartësitë e flukseve të parasë dhe kohën e këtyre flukseve.

Vlera e tregut per investimet në pasuri të paluajteshme të Entitetit Raportues është vlerësuar nga ekspert i pavarur, i licensuar dhe me eksperiencë në vlerësimin e pasurive të ngjashme.

E ardhura nga qeratë është njohur në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve për vitin operacional si të ardhura te tjera operacionale. Ndryshimet në vlerën e tregut të investimit në pasuri të paluajtshme janë njohur në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve per vitin operacional të ndara nga të ardhurat nga qeraja.

(m) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Entitetit Raportues, me përjashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperushme e aktivit, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje..

(n) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje nga të ardhurat, neto nga tatimi. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si pronë e aksioneve në kapitalin neto.

Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo divident i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se të mbyllen pasqyrat financiare, janë shprehur në shënimet e ngjarjeve pas periudhës.

(o) Rezerva e rrezikut të sigurimit

Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në Nenin 93 të Ligjit për Sigurimet dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluara të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më tepër se 30% e primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë.

(p) Njohja e të ardhurave

i) Primet

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë sqaruar në shënimin 5(c).

ii) Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesi njihen në fitimin ose humbjen si të fituara, duke marrë parasysh interesin efektiv të aktivit. Të ardhurat nga dividenti njihen në fitim ose humbje në datën e deklarimit të dividendit.

iii) Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet përfshijnë komisionin e risigurimit, të njohur në marrëveshjen me risiguruesit. Në përputhje me përjashtimin e lejuar nga SNRF 4, komisionet e risigurimit vazhdojnë të njihen plotësisht në marrëveshjen me risiguruesin.

iv) Të ardhurat nga qiraja

E ardhura nga qeraja njihet në bazë të të drejtave të konstatuara

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(q) Kostot e blerjes së policave

Shpenzimet e blerjes përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin dhe lëshimin e policave.

Kostot e blerjes së drejtpërdrejtë shtyhen gjatë afatit të policave në fuqi me një metodë në përputhje me llogaritjen e provizioneve të primeve të pafituara dhe paraqiten bruto nga detyrimet e lidhura të sigurimit si një aktiv. Shpenzimet e shtyra të blerjes amortizohen sistematikisht gjatë jetës së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk kthehet regjistrohet si shpenzim.

Kostot e marrjes në sigurim

Shpenzimet e blerjes janë ato kosto që ndryshojnë dhe lidhen kryesisht me blerjen e kontratave të reja të sigurimit dhe rinovimit të tyre. Komisionet dhe shpenzimet e tjera (p.sh., pagat e punonjësve të përfshirë në funksionet e nënshkrimit të policave dhe tarifat mjekësore dhe inspektuese) që lidhen kryesisht me kontratat e sigurimit të lëshuara ose të përtëritura gjatë periudhës në të cilën kostot lindin, konsiderohen shpenzimet e blerjes .

Shpenzimet e blerjes kapitalizohen dhe ngarkohen me shpenzime në proporcion me të ardhurat e pritura të njohura. Për të lidhur kostot e blerjes me të ardhurat përkatëse të primit, kostot e blerjes ndahen nga grupimet e kontratave të sigurimit në përputhje me mënyrën e blerjes, shërbimit dhe matjes së rentabilitetit të kontratave të sigurimit të Entitetit Raportues. Kostot e blerjes të paamortizuara klasifikohen si një aktiv.

(r) Kostot e trajtimit te dëmeve

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Entiteti Raportues krijon provizione për kostot e trajtimit të dëmeve.

(s) Shpenzimet

i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

ii) Përfitimet e punonjësve

Pagat, shpërblimet, kontributet në fondet shtetërore ose private, fondet e sigurimeve shoqërore, pushimet vjetore dhe pushimet mjekësore, shpërblimet dhe përfitimet jo monetare grumbullohen në vitin në të cilin shërbimet janë kryer. Entiteti Raportues nuk ka asnjë detyrim ligjor për të bërë pagesa të pensioneve ose përfitimeve të ngjashme përtej pagesave në skemën e kontributeve të përcaktuara statutore dhe private.

iii) Pagesat e qerasë operative

Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën humbje fitimeve me metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

(t) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit.Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto.

(u) Krahasueshmëria

Për paraqitjen më të qëndrueshme të transaksioneve, klasifikimi i disa elementeve në informacionin krahasues financiar është ndryshuar për të qenë në përputhje me trajtimin e vitit aktual..

6. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël

Menaxhimi bën gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekura.

Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme dhe relevante në rrethanat. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

6. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)

Pretendimet dhe përfitimet e policëmbajtësit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga pretendimet e bëra sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël i Entitetit Raportues. Vendimet e Enitetit Raportues për humbjet e raportuara dhe të papërmendura dhe vendosja e provigoneve rezultuese dhe risigurimi i lidhur me të, rikuperohen çdo vit dhe përditësohen dhe rregullimet që rrjedhin nga ky rishikim pasqyrohen në fitim ose humbje. Procesi bazohet në supozimin se përvoja e kaluar, e përshtatur për efektin e zhvillimeve aktuale dhe tendencat e mundshme, është një bazë e përshtatshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit diskutohet në detaje në Shënimin 8, ndërsa dispozitat e kontratës së sigurimit analizohen në Shënimin 24 dhe 25

Pasuritë e paluajtshme dhe investimi në pasuri të paluajtshme të njohura me vlerë tregu

Investimi në pasuri të paluajtshme është njohur me vlerën e tregut bazuar në raportin e ekspertit të pavarur në mbyllje të vitit financiar. Si rezultat i ambjentit ekonomik ekzistues, transaksionet e pasurive të paluajtshme kanë një frekuencë të ulët. Megjithatë, në vlerësimin e manaxhimit evidence e marrë nga tregu është e mjaftueshme për të krahasuar cmimet e transaksioneve të ngjashme në mënyrë që të nxirret vlera e tregut të investimeve në pasuri te paluajtshme. Gjatë përgatitjes së raportit të vlerësimit të vlerës së tregut për investimet në pasuri të paluajtshme të Entitetit Raportues, eksperti i pavarur, ka përjashtuar nga vlerësimi shitjet e pasurive të ndodhura në kushte jo konkurruese. Manaxhimi ka kontrolluar supozimet e bëra nga eksperi i pavarur lidhur me modelin e flukseve të ardhshme të parasë, dhe konfirmon që faktorë të tillë si norma e skontimit, janë aplikuar në mënyrë korrekte bazuar në kushtet e tregut në përfundim të periudhës së raportimit. Pavarësisht sa me sipër, manaxhimi e konsideron vlerësimin e investimit në pasuri te paluajtshme si të bazuar në gjykime subjektive dhe se ekziston mundësia që transaksionet aktuale në treg mund të kenë vlera të ndryshme.

Parimet kryesore të përdorura në vlerësimin e pasurive të paluajtshme janë: lidhja e kontratave të qerasë; pritshmëria për flukset e ardhshme të parasë; periudhat pezull (pa qeramarreë); nevojat për mirëmbajtje; norma skontimi adekuate. Keto vlerësime krahasohen në mënyrë të rregullt me të dhënat nga tregu.

Fondi i kompesimit

Fondi i kompesimit, bazuar në ligjin 10076, datë 12 shkurt 2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" neni 45 përdoret për të shlyer dëmet që vijnë prej:

- Mjeteve motorrike të pasiguruara;
- Mjeteve motorrike të pa identifikuara;
- detyrimeve të çdo shoqërie sigurimi që ndërpret veprimtarinë ose likuidohet;

Byroja Shqiptare e Sigurimeve ("BSHS") përcakton fondin vjetor për vitin brënda fundit të vitit paraprak. Këto janë miratuar nga AMF brënda të njëjtit vit.

AMF miratoi fondin për vitin 2018 që do t'u ndahej kompanive të sigurimit dhe BSHS gjithashtu përcaktoi shumën që duhet paguar nga secila kompani sigurimi për vitin 2018. Në njohjen e detyrimeve që rrjedhin nga fondi i kompensimit, shoqëria merr parasysh shumat e përcaktuara nga BSHS dhe të miratuara nga AMF. Për më tepër, menaxhimi i konsideron këto detyrime aktuale për vitin e përcaktuar nga AMF, pavarësisht se kur shuma bëhet e sigurt, pasi detyrimi për fondin e kompensimit bëhet aktual kur përcaktohet nga rregullatori dhe është detyrim për tu shlyer në periudhën në të cilën ajo është detyrim. Gjithashtu, menaxhimi i referohet dispozitave të rregullatorit për njohjen e këtyre detyrimeve.

Të arkëtueshmet nga sigurimet dhe humbjet nga zhvlerësimi

Sigurimet dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë. Më pas të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i kompensimit për humbjet nga zhvlerësimi është gjithashtu një vlerësim i kryer nga menaxhimi. Të arkëtueshmet e sigurimeve vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Të arkëtueshmet e sigurimeve me më shumë se një vit zhvlerësohen plotësisht nëse nuk ka probabilitet të lartë që ato të mblidhen. Një probabilitet i tillë ekziston kur shoqëria ka marrëdhënie afatgjatë me klientë të rëndësishëm ose kur shoqëria blen mallra dhe / ose shërbime nga i siguruari dhe llogaritë e arkëtueshme shlyhen në baza neto. Të arkëtueshmet e sigurimeve me më pak se një vit janë vlerësohen individualisht në rast se ka tregues se ato të nuk do të mblidhen dot.

Të arkëtueshmet e sigurimeve me më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në baza kolektive të grupuara në bazë të karakteristikave të rrezikut të kredisë, zakonisht me datën e raportimit. Përqindjet e zhvlerësimeve të aplikuara për secilën kategori të llogarive të arkëtueshme të sigurimeve me më pak se një vit, përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të menaxhimit për humbjet e pritshme në të ardhmen dhe bazohen në historinë e rikuperueshmërisë dhe përvojën e tregut.

10. Aktive afatgjata material dhe jo - materiale

	Ndërtesa	Permiresime te ambjenteve te marra me qera	Mjete motorrike	Pajisje kompjuterike dhe zyre	Programe kompjuterike	Vepra arti	Totali
Kosto ose vlerësim							
Në 1 janar 2017	**334,494**	**10,470**	**67,679**	**118,028**	**31,309**	**150**	**562,130**
Shtesa	1,000	-	6,682	5,380	6,595	-	**19,657**
Pakësime	-	-	(3,716)	-	-	-	**(3,716)**
Në 31 dhjetor 2017	**335,494**	**10,470**	**70,645**	**123,408**	**37,904**	**150**	**578,071**
Shtesa	-	-	6,049	9,213	25,156	-	**40,418**
Transferime nga AAM te investuara	28,154	-	-	-	-	-	**28,154**
Pakësime	-	(10,470)	(4,345)	(256)	-	-	**(15,071)**
Në 31 dhjetor 2018	**363,648**	-	**72,349**	**132,365**	**63,060**	**150**	**631,572**
Amortizimi i akumuluar							
Në 1 janar 2017	**92,459**	**1,557**	**54,331**	**97,744**	**22,892**	-	**268,983**
Shpenzimi i vitit	12,110	446	3,986	7,616	3,305	-	**27,463**
Am.Akum.pakesime	-	-	(3,716)	-	-	-	**(3,716)**
Në 31 dhjetor 2017	**104,569**	**2,003**	**54,601**	**105,360**	**26,197**	-	**292,730**
Shpenzimi i vitit	13,402	423	4,403	5,774	6,892	-	**30,894**
Am.Akum.pakesime	-	(2,426)	(4,345)	(256)	-	-	**(7,027)**
Në 31 dhjetor 2018	**117,971**	-	**54,659**	**110,878**	**33,089**	-	**316,597**
Net book value							
Në 31 dhjetor 2017	**230,925**	**8,467**	**16,044**	**18,048**	**11,707**	**150**	**285,341**
Në 31 dhjetor 2018	**245,677**	-	**17,690**	**21,487**	**29,971**	**150**	**314,975**

Vlera e drejtë e ndërtesave është përcaktuar nga ekspertë të jashtëm të cilët kanë kualifikimet dhe eksperiencën e duhur në kategorinë përkatëse të aktiveve që kanë vlerësuar. Vlerësuesit e pavarur përcaktojnë çdo 3 vjet vlerën e drejtë të pronave të përdorura të Entitetit Raportues për realizimin e aktivitetit. Matja e vlerës së drejtë për ndërtesat ka qenë e kategorizuar si vlera e drejtë e nivelit 3. Vlera e drejtë e ndërtesave sipas raportit të vlerësimit të realizuar në dhjetor 2018 është 245,677 mijë Lekë.

Shpenzimi i amortizimit është njohur në "shpenzimet administrative" në pasqyren e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

11. Aktivet afatgjata materiale të investuara

	2018	2017
Gjendja më 1 janar	107,189	112,066
Ndryshimi nga vlera e drejtë	(6,185)	(4,877)
Riklasifikim ne AAM	(28,154)	
Gjendja më 31 Dhjetor	**72,850**	**107,189**

Vlerësimi i pronave kryhet nga një ekspert i pavarur bazuar në Standardet Europiane të Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme dhe Standardeve Ndërkombëtare. Metoda e vlerësimit e përdorur është krahasimi i drejtpërdrejtë, ku prona vlerësohet bazuar në çmimin e shitjes së pronave të ngjashme (vendndodhja, përdorimi dhe madhësia e pronave të njëjta) në tregun shqiptar. Inputet e përdorura nga vlerësuesi janë çmimet e shitjes dhe metra katrorë të pronës.

Nje rritje/ulje prej 10 % ne çmimet e tregut, krijon nje efekt prej 7,285 mije Lek me 31 dhjetor 2018 (31 dhjetor 2017:10,712 Lek).

12. Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta

	2018	2017
SIVIG Vienna Insurance Group-Dega Kosove (i)	201,143	201,143
VIG Services sh.p.k. (ii)	14,654	11,404
Total	**215,797**	**212,547**

(i) 201,143 mijë Lek përfaqëson investimin e Shoqërise në degën e Kosovës. Siç u përshkrua në pikën 5 (a) Shoqëria nuk konsolidon degën Kosovë në këto pasqyra financiare.

(ii) 14,654 mije Lek (2017: Lek 11,404 mije) perfaqson investimin me 50 % (2017: 50% te Shoqerise ne kapitalin e VIG Services Sh.p.k, nje entitet themeluar ne 2012 si një qendër shërbimesh e përbashkët me qëllim sigurimin e shërbimeve menaxhuese ndaj entiteteve të VIG që operojnë në Shqipëri. Shoqëria ka njohur pjesën e saj nga fitimi i akumuluar i VIG Services sh.p.k në shumën 3,250 mijë Lek

13. Aktive të risigurimit

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pjesa e risiguruesit në primin e pafituar	453,529	461,034
Pjesa e risiguruesit ne dëmet e raportuara	760,337	929,280
Total	**1,213,866**	**1,390,314**

Aktivet e risigurimit të Entitetit Raportues nuk janë të siguruara dhe as në vonesë apo të provizionuara. Aktivet monitorohen sipas vlerësimit të kredisë. Për fund vitin 31 dhjetor 2018 dhe 2017 rreziku i kredisë të primeve të ceduara të risigurimit sipas vlerësimit (kërkesë e legjislacionit lokal) është si më poshtë:

	2018				2017			
	Prime të ceduara		Aktive të risigurimit		Prime të ceduara		Aktive të risigurimit	
	'000 Lek	% e totali	'000 Lek	% e totali	'000 Lek	% e totali	'000 Lek	% e totalit
Vlerësimi								
AA	18,452	1.8	6,807	0.6	25,569	2.4	12,242	0.9
AA-	21,765	2.2	34,060	2.8	24,026	2.3	40,706	2.9
A+	958,074	94.9	1,160,121	95.6	992,453	94.0	1,323,639	95.2
A	179	0.0	5,710	0.5	2,786	0.3	4,376	0.3
A-	10,949	1.1	7,168	0.6	11,011	1.0	9,351	0.7
Pa vlerësuar	-	-	-	-	-	-	-	-
Total	**1,009,418**	**100**	**1,213,866**	**100**	**1,055,845**	**100**	**1,390,314**	**100**

14. Aktive financiare të mbajtura deri në maturim

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Totali në vlerë nominale	1,353,190	1,221,401
Prim i paamortizuar	37,843	47,422
Interes i akumuluar	24,098	20,964
Total	**1,415,131**	**1,289,787**

Në 31 dhjetor 2018 Entiteti Raportues investoi në bono thesari dhe obligacione qeveritare të Bankën e Shqipërisë, me maturitet që mbaron në afat 1 vit deri ne 10 vjet dhe normë interesi fikse prej 1.65% deri më 9.25 % (2017: maturiteti që mbaron në afat 2 vjet deri ne 10 vjet dhe normë interesi fikse prej 2.7% deri më 9.25 %). Vlerësimi nga Moodys eshte B1 për qeverinë shqiptare.

15. Depozita me afat me banka

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Depozita bankare	487,832	402,967
Fondi I garancisë	382,046	380,645
Interes I akumuluar	6,291	4,436
Total depozita bankare dhe fondi I garancisë	**876,169**	**788,048**

Në përputhje me Nenin 81 te Ligjit për Sigurimet, përsa i përket fondit të garancisë, Entiteti Raportues mban një minimum prej 1/3 të nivelit të kërkuar të marzhit të aftësisë paguese por jo më pak se 370 milion Lek, në bono thesari dhe depozita me afat me maturitet prej jo më pak se 1 vit. Më 31 dhjetor 2018, fondi i garancisë ishte 382,046 mijë Lek (2017: 380,645 mijë Lek).

Fondi i garancisë përbëhet nga depozitat bankare të bllokuara pranë bankave tregtare të Republikës së Shqipërisë. Fondi i garancisë mund të investohet vetëm përmes sistemit bankar në depozita me afat ose bono thesari dhe nuk është disponibël për operacione të përditshme.

Depozitat me afat me bankat përfshijnë depozitat e mëposhtme në Lek dhe monedhë të huaj më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor2017	
	Shumat	Interesi në %	Shumat	Interesi në %
Në EUR	150,037	0.1-1.5	152,379	0.05-1.5
Në Lek	726,132	0.1-3.2	635,669	1.2-2.5
Totali	**876,169**		**788,048**	

Depozitat bankare, duke përjashtuar fondin e garancisë,kanë maturitete nga 12 muaj deri në 3 vjet.

15. Depozita me afat me banka (vazhdim)

Mjetet monetare dhe depozitat e kompanisë janë vendosur pranë institucioneve financiare si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018		31 Dhjetor 2017	
Vlerësimi	**Depozita dhe llogari rrjedhëse**	**Nga të cilat llogari rrjedhëse (nota 19)**	**Depozita dhe llogari rrjedhëse**	**Nga të cilat llogari rrjedhëse (nota 19)**
B	-	-	136	136
B-	2,960	2,960	3,186	3,186
B+	10,337	1,231	11,634	2,692
B2	85,814	23,988	77,086	7,838
BBB	221,293	18,958	163,344	5,723
BBB-	341,589	102,546	314,116	75,063
BBB+	163,205	40,973	87,333	20,253
CCC+	3,586	3,586	12,347	12,347
Not rated	255,719	14,092	258,782	12,678
Total	**1,084,503**	**208,334**	**927,964**	**139,916**

Njësia raportuese vepron me bankat vendase, të cilat janë kryesisht filiale të grupeve bankare ndërkombëtare. Llogaritë me bankat nuk janë të siguruara. Duke qene se pak banka shqiptare vlerësohen nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, Njësia Raportuese përdor vlerësimet e kreditit të aksionerëve më të mëdhenj të bankave për të marrë vendimet e tyre të investimeve si dhe raportet tremujore të Bankës së Shqipërisë mbi bankat që operojnë në treg.

16. Kostot e shtyra te marrjes ne sigurim

	2018	**2017**
Komisione të agjentëve dhe kosto të tjera	294,641	298,122
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	(30,716)	(26,052)
Totali	**263,925**	**272,070**

Lëvizjet në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë si më poshte:

	2018	**2017**
Gjendja më 1 janar	272,070	235,195
Rritje në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	612,969	687,207
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim te përdorura	(621,114)	(650,332)
Më 31 Dhjetor	**263,925**	**272,070**

17. Llogari te arketueshme nga sigurimi dhe te tjera

Të arkëtueshmet nga sigurimet përbëhen si më poshtë:

	2018	**2017**
Të arkëtueshme nga policëmbajtësit	49,213	81,645
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimit	108,564	153,202
Total	**157,777**	**234,847**

17. Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera (vazhdim)

Të arkëtueshmet bruto dhe neto nga zbritja e të arkëtueshmeve të dyshimta paraqiten si më poshtë:

	2018	2017
Të arkëtueshmet nga sigurimet, bruto	251,920	520,524
Minus: Zbritja për humbjet nga zhvlerësimet	(94,143)	(285,677)
Të arkëtueshme nga sigurimet, neto	**157,777**	**234,847**

Lëvizjet në zbritjet për humbje nga zhvlerësimet detajohen si më poshtë:

	2018	2017
Gjendja më 1 janar	285,677	268,102
Zhvlerësimi për vitin	15,000	17,575
Fshirjee llogarive te arketueshme	(206,534)	
Gjendja më 31 dhjetor	**94,143**	**285,677**

Cilesia e kreditit të llogarive të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
As me vonesë as të zhvlerësuara	108,564	153,202
Me vonesë por të pa zhvlerësuara	32,413	63,095
Të provizionuara	110,943	304,227
Totali i të arkëtueshmeve bruto	251,920	520,524
Minus: Zbritja nga fondi i zhvlerësimit	(94,143)	(285,677)
Totali	**157,777**	**234,847**

Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi nuk janë të siguruara.

Të arkëtueshmet nga policëmbajtesit (bruto) më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 në bazë të statusit të tyre të vonesave janë paraqitur në tabelën vijuese.

	31 dhjetor 2018			
	Bruto	Zhvlerësimi	Neto	%
1 deri në 3 muaj	58,472	-	58,472	37.1%
3 muaj deri në 1vit	29,550	(15,047)	14,503	9.2%
Më shumë se një vit	163,898	(79,096)	84,803	83.7%
Total	**251,920**	**(94,143)**	**157,777**	**100%**

	31 dhjetor 2017			
	Bruto	Zhvlerësimi	Neto	%
1 deri në 3 muaj	83,057	-	83,057	35.40
3 muaj deri në 1vit	113,543	(4,698)	108,845	46.30
Më shumë se një vit	323,924	(280,979)	42,945	18.30
Total	**520,524**	**(285,677)**	**234,847**	**100**

18. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të arkëtueshme nga kompani të lidhura	104	1,212
Paradhënie për punonjësit	32,883	38,774
Aktive të tjera financiare	**32,987**	**39,986**
Shpenzime të parapaguara	9,771	18,082
Garanci për kartonin jeshil	59,486	64,079
Inventarët	4,413	4,081
Garanci për qera	1,393	3,015
Të ndryshme	7,084	7,084
Totali	**115,134**	**136,327**

Paradhëniet e punonjësve nuk janë as me vonesë, as të zhvlerësuara.Këto paradhënie mbahen nga pagat e punonjësve dhe/ose kompensohen me detyrime të tjera kur njësia raportuese e shikon të arsyeshme.

Të tjera lidhen me investimet e kapitalit jo të kontrolluara të Shoqërise dhe detajohen si më poshtë:

	2018	2017
Justicia	2,000	2,000
Dajti Ekspres	5,084	5,084
Total	**7,084**	**7,084**

Pjesëmarrjet në Justicia, janë të bllokuara.

19. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Para në dorë	222	323
Llogari rrjedhëse	196,641	128,531
Para në bankë në Lek	*95,366*	*59,788*
Para në bankë në valutë	*101,275*	*68,743*
Mjete monetare dhe ekuvalentë	**196,863**	**128,854**
Llogari te bllokuara	11,691	11,385
Totali	**208,554**	**140,239**

Cilësia e rrezikut të kreditit të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve paraqitet në shënimin 15.

20. Kapitali aksionar

Kapitali aksioner i Shoqërise në 31 dhjetor2018 është 498,213 mijë Lek (2017: 498,213 mijë Lek) i ndarë në 39,627 aksione me vlere nominale 12,572.57 Lek. Në 31 dhjetor 2018 dhe 2017 struktura e askionereve është si më poshtë:

	Nr.aksione	Shuma në '000 Lek	In %
Vienna Insurance Group AG Eiener Versicherung Gruppe	35,289	443,673	89.05%
Zj. Shpresa Prodani	1,778	22,354	4.49%
Z. Qemal Disha	1,480	18,607	3.73%
Z. Rasim Disha	296	3,721	0.75%
Zj. Shefikat Ngjela	488	6,135	1.23%
Z. Idajet Kuka	296	3,721	0.75%
Total	**39,627**	**498,213**	**100%**

21. Rezerva per rreziqe te tjera

Rezervat e rrezikut të sigurimit
Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në Ligjin për Sigurimet dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluara të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më tepër se 30% e primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit në lidhje me veprimet në Shqipëri. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë. Gjatë vitit 2018 Entiteti Raportues nuk e ka ndryshuar rezervën e risigurimit në Vlerë 171,792 mijë Lek.

Rezerva e rivlerësimit
Rezerva e rivlerësimit lidhet me matjen e pronave në vlerë të drejtë ku teprica e rivlerësimit njihet në rezervën e rivlerësimit në kapital permes të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Rezerva e bashkimit

Rezerva e bashkimit në shumën 387,207 mijë Lek përfaqson aktivet neto të Interalbanian në 9 Tetor 2014, të cilat janë inkorporuar në aktivet e Entitetit Raportues në datën e bashkimit sipas kushteve të marrëveshjes së bashkimit.

22. Detyrime nga kontratat e sigurimit

	2018	2017
Gjendja më 1 Janar		
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	1,593,890	1,399,782
Pjesa e risiguruesit (shënim **Error! Reference source not found.**)	(929,280)	(812,927)
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	***664,610***	***586,855***
Dëme të ndodhura	682,172	642,737
Dëme të paguara	(618,994)	(564,982)
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	**727,788**	**664,610**
Pjesa e risiguruesit (shënim **Error! Reference source not found.**)	760,337	929,280
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve në fund të vitit	**1,488,125**	**1,593,890**
Ndryshimi bruto në rezervat për dëmet nga sigurimi	105,765	(194,108)
Minus: Pjesa e risiguruesve	(168,943)	116,353
Ndryshime në rezervën për dëme, neto	**(63,178)**	**(77,755)**

Ndryshimi bruto në rezervat e sigurimit të dëmeve përbëhet nga ndryshimi bruto në rezervat për dëmet e raportuara por ende të pashlyera dhe në dëmet e ngjara por ende të paraportuara. Rezervat për detyrimet dhe humbjet e sigurimit për 2017 nuk janë aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në datën e lëshimit të pasqyrave financiare.

Dëmet e paguara sipas produkteve janë si më poshtë:

	2018	2017
Mjete motorrike	716,195	709,660
Pasuri	38,673	116,153
Shendeti	1,337,212	135,944
Deme te paguara nga risiguruesi	(1,473,086)	(396,775)
Totali	**618,994**	**564,982**

23. Rezerva e primit te pafituar

	2018	2017

Gjendja më 1 janar	1,005,552	1,002,242
Prime të shkruara gjatë vitit (shiko shënimin 28)	2,219,929	2,138,869
Minus: Prime të fituara gjatë vitit	(2,173,323)	(2,135,559)
Balanca në 31 dhjetor	**1,052,158**	**1,005,552**

	2018	**2017**
Ndryshimi bruto në rezervën për primin e pafituar	(46,606)	(3,310)
Ndryshimi në pjesën e risiguruesve	(7,505)	40,473
Ndryshimi në rezervën për primin e pafituar, neto	**(54,111)**	**37,163**

24. Detyrime tatimore dhe të tjera

Detyrimet ndaj tatimeve dhe të ngjashme, përbëhen si më poshtë:

	2018	**2017**
Taksa e primit e pagueshme	5,723	21,468
Taksa shtetërore dhe vendore të pagueshme	6,726	6,328
Detyrime për sigurime shoqerore	5,347	5,794
Totali	**17,796**	**33,590**

25. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera

Detyrime të sigurimit dhe të tjera përbëhet nga:

	2018	**2017**
Të pagueshme ndaj risiguruesve	980,711	975,939
Të pagueshme ndaj personelit	15,685	8,528
Të pagueshme ndaj AMF	3,505	2,310
Te pagueshme ndaj agjentëve dhe ndërmjetëësve	68,151	55,116
Te pagueshme ndaj kompanive të sigurimit	43,396	51,236
Të tjera të pagueshme	30,708	25,892
Totali	**1,142,156**	**1,119,021**

Të pagueshme ndaj risiguruesve përfshin depozitën e risiguruesit me vlerën 893,697 mije Lek (2017: 878,310 mijë Lek). Entiteti Raportues nënshkroi një marrëveshje me VIG Holding të tillë që të gjitha aktivet e risigurimit me Vig Holding do të paraqitet si një depozitë me një normë të paracaktuar të interesit dhe jo si detyrim ndaj risiguruesit.

26. Prime te shkruara bruto

Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe të risigurimit sipas produkteve detajohen si më poshtë:

	2018	2017
Mjete motorrike	1,777,752	1,659,020
Pasuri	330,911	351,538
Shëndet	91,072	108,859
Garanci	20,194	19,452
Totali	**2,219,929**	**2,138,869**

Primet e mjeteve motorrike detajohen si më poshtë:

	2018	2017
TPL	1,384,840	1,271,952
Karton Jeshil	200,324	214,253
Kasko	130,219	111,984
Polica Kufitare	62,369	60,831
Totali	**1,777,752**	**1,659,020**

27. Prime te ceduara ne risigurim

Primet e ceduara të risiguruesit sipas produkteve të sigurimit detajohen si më poshtë:

	2018	2017
Mjete motorrike	770,120	786,576
Pasuri	233,827	265,002
Shëndet	5,471	4,267
Totali	**1,009,418**	**1,055,845**

28. Te ardhura të tjera

	2018	2017
Qera dhe të ardhura nga shërbimet	722	2,218
Të ardhura të tjera	4,843	13,842
Totali	**5,565**	**16,060**

29. Kosto të marrjes në sigurim

	2018	2017
Motorike	488,389	505,119
Pasuri	83,307	86,117
Shëndeti	30,650	38,358
Përgjegjësi	7,068	7,273
Garanci	5,032	4,959
CAR	5,385	7,313
Kargo	1,283	1,193
	621,114	**650,332**
Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim	8,144	(36,875)
Totali	**629,258**	**613,457**

30. Shpenzime administrative

	2018	2017
Personeli	106,649	89,340
Utilitetet dhe qeraja	30,551	27,792
Reklamë dhe marketing	30,220	31,182
Amortizim	29,038	31,484
Të tjera	25,173	22,026
Konsulencë e jashtme	16,576	12,295
Gjoba	16,278	2,169
Shërbime financiare	15,107	14,621
Provizionime/zhvlerësime për sigurime dhe të arkëtueshme të tjera	15,000	24,904
Shpenzime IT	14,923	19,153
Shpenzime bankare	6,766	4,935
Provizione për çështje gjyqësore	6,044	48,228
Karburant dhe Transport	5,387	5,143
Mbikqyrje dhe tarifa të tjera	5,304	5,701
Udhëtime dhe dieta	4,798	5,853
Mirëmbajte dhe riparime	3,289	3,766
Sherbime auditimi	2,913	4,186
Internet	1,615	1,169
Totali	**335,631**	**353,947**

Në vitin 2018, numri mesatar i punonjësve ishte 222 (2017: 229 punonjës).Kostot e personelit përbëhen si më poshtë:

	2018	2017
Paga	96,878	79,580
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	9,771	9,760
Totali	**106,649**	**89,340**

31. Shpenzime të tjera sigurimi

	2018	2017
Kontributi AMF 1.5%	26,505	22,369
Taxa e primit	-	-
Kontributi BSHS	8,609	8,186
Total	**35,114**	**30,555**

Bazuar në ndryshimin e legjislacionit mbi procedurat tatimore, tatimi i primit prej 10% trajtohet dhe llogaritet ndryshe në vitin 2017, ngjashëm me tatimin mbi vlerën e shtuar dhe nuk ndikon në fitimin ose humbjen. Taksa e primit tani paguhet direkt nga mbajtësit e policave veçmas nga primet e shkruara bruto dhe kompanitë e sigurimit duhet të veprojnë si agjentë për mbledhjen e tatimit pa ndikuar në primet e tyre bruto të shkruara ose shpenzimet.

32. Të ardhura nga investimet

Të ardhura nga interesi për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 është përfituar nga aktivet e mëposhtme:

	2018	2017
Interesi nga depozitat	12,392	10,725
Interesi nga bonot e thesarit	76,651	62,640
Interesi nga aktivet korrente dhe të tjera	9	15
Totali	**89,052**	**73,380**

33. Humbje nga kurset e këmbimit,neto

	2018	2017
Fitime nga kursi i këmbimit, bruto	120,044	64,054
Humbje nga kursi i këmbimit, bruto	(89,981)	(68,093)
Totali	**30,063**	**(4,039)**

34. Tatim fitimi

(a) Përbërësit e shpenzimit të tatim fitimit (të ardhurës)

Shpenzimi I tatim fitimit I njohur ne pasqyrën e fitim humbjeve përbëhet si më poshtë:

	2018	2017
Tatim fitimi i periudhës	23,440	22,724
Tatim i shtyrë	-	-
Shpenzim tatim fitimi	**23,440**	**22,724**

(b) Rakordimi midis shpenzimit të tatimit dhe rezultatit llogaritur me normën e tatimit të aplikuar

Norma e aplikueshme e tatim fitimit për Njësitë Raportuese në Shqipëri në 2018 është 15 % (2017: 15%). Një krahasim midis shpenzimit të pritur dhe atij actual të tatim fitimit është si në tabelën më poshtë:

	2018	2017
Fitim/Humbje para tatimit	**123,849**	**66,490**
Tatim fitimi teorik bazuar ne normen ne (2018: 15%; 2017: 15%)	18,577	9,974
Efektet tatimore te zerave te cilet jane te pazbritshem per efekte tatimore:		
Shpenzime të panjohura	4,863	12,750
Mosnjohja e humbjes së mbartur të papërdorur	-	-
Shpenzimi I tatim fitimit te periudhes	**23,440**	**22,724**

34. Tatim fitimi (vazhdim)

c) Analiza e tatimit të shtyrë bazuar në diferencat e përkohshme:

Diferencat midis SNRF-ve dhe rregullave tatimore ligjore në Shqipëri japin diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe bazave të tyre tatimore. Efekti tatimor i lëvizjeve në këto diferenca të përkohshme është detajuar më poshtë

31 dhjetor 2018	Balanca neto më 01 janar	Njohur në fitim/humbje	Njohur nw OCI	Balanca neto me 31 dhjetor	Aktiv tatimor i shtyrë	Pasiv tatimor i shtyrë
Aktive afatgjata materiale	(8,888)	-	981	(7,907)	-	(7,907)
Tatim i shtyrë(detyrim)	**(8,888)**	**-**	**981**	**(7,907)**	**-**	**(7,907)**
31 dhjetor 2017	**Balanca neto më 01 janar**	**Njohur në fitim/humbje**	**Njohur nw OCI**	**Balanca neto me 31 dhjetor**	**Aktiv tatimor i shtyrë**	**Pasiv tatimor i shtyrë**
Aktive afatgjata materiale	**(9,590)**	**-**	**702**	**(8,888)**	**-**	**(8,888)**
Tatim i shtyrë(detyrim)	**(9,590)**	**-**	**702**	**(8,888)**	**-**	**(8,888)**

Detyrimi tatimor i shtyrë i atribuohet ndërtesave në vlerë të drejtë duke sjellë një tepricë positive nga rivlërisimi. Detyrimi tatimor i shtyrë llogaritet tek kjo tepricë shtesë që njihet në kapital tek llogaria e rezervës nga rivlerësimi, nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Një detyrim i tillë tatimor i llogaritur sipas normës së tatimit shqiptar prej 15% është njohur drejtpërdrejt në capital nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.